



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT/MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS
DRŽAVNA AGENCIJA ARHIVA KOSOVA
THE STATE AGENCY OF KOSOVO ARCHIVES

KONCEPT DOKUMENTI

për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-088 për Arkivat shtetërore

Prishtinë, 2018

Kapitulli 1: Hyrje

Legjislacioni në fuqi për Arkivat Shtetërore rregullon çështjen e grumbullimit, mbrojtjes, ruajtjes, rregullimit, përpunimit, publikimit, prezantimit dhe shfrytëzimit të lëndës arkivore. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës është institucion përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollimin dhe zbatimin e standardeve për ruajtjen e trashëgimisë së shkruar kulturore arkivore me vlerë të përhershme të ruajtjes.

Korniza e tashme ligjore, e cila i rregullon aktivitetet në fushën e veprimtarisë arkivore duhet të avancohet edhe më tej, në mënyrë që të fuqizohet funksionimi i përgjithshëm i veprimtarisë arkivore, si dhe të sigurohemi se kompetencat dhe detyrat e tyre do të kryhen në mënyrë sa më efikase dhe efektive.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-088, për Arkivat Shtetërore “GZ” dt. 19.03.2012, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës si institucioni më i lartë arkivor në vend, në këtë periudhë të zbatueshmërisë së këtij Ligji në shumë raste është ballafaquar me zbrazëtira juridike, me mungesë norme, që e kanë vështirësuar shumë ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë arkivore në vend.

Ligji aktual është i zbatueshëm, por mungojnë disa dispozita, e po ashtu disa dispozita kanë nevojë për riformulim apo plotësim ndryshim, të cilat po e vështirësojnë zhvillimin e veprimtarisë arkivore në Kosovë. Të gjitha mangësitë janë të specifikuara në pjesët përkatëse të këtij Draft Koncept Dokumenti. Andaj, e shohim të domosdoshëm plotësim ndryshimin e këtij ligji me qëllim të eliminimit të mangësive dhe paqartësive siç janë mungesa e dispozitave për: dispozitat ndëshkimore; licencimin e profesionit të arkivistit; Organin rekomandues/këshillëdhënës për arkiva; dispozitat që e rregullojnë çështjen e eksport- importit të dokumenteve arkivore; dispozitat mbi blerjen e lëndës arkivore; ruajtja e dokumentacionit në kohë dhe rrethana të veçanta dhe të jashtëzakonshme; ndarja e kompetencave në mes të arkivave qendrore dhe lokale; definimi me ligj i rrjetit arkivor; *ndërrimi i emrit të Agjencisë*, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në Agjencia Arkivore Shtetërore e Kosovës (AASHK).

Plotësim-ndryshimet e lartpërmendura të ligjit aktual në këtë fushë evitojnë situata të tilla, të cilat janë pengesë dhe mund të thellohen edhe më shumë në të ardhmen.

Ndërrimet e kornizës ligjore përmes integritetit të ligjeve të aplikueshme, si dhe shtimit të elementeve do të bëjnë të mundshme ngritjen e sistemit më funksional, më të sigurt dhe më

lehtë të përdorshëm në menaxhimin dhe kontrollimin e dokumentacionit që krijohet në Republikën e Kosovës, e që ka rëndësi dhe vlerë të ruajtjes së përhershme.

Me këtë rast, në vazhdim kemi theksuar çështjet më imediate dhe më qenësore që duhet plotësuar, por mund të zgjerohet dhe të detajohet më tej gama e çështjeve plotësuese në këtë fushë.

Kapitulli 2: Përshkrimi i çështjes/problemimit kryesor

Shpjegim

Që nga hyrja në fuqi e Ligjit , përkatësisht gjatë zbatimit të këtij ligji janë hasur disa vështirësi si rezultat i mangësive dhe paqartësive të disa dispozitave. Për këtë arsye është parë i domosdoshëm plotësim-ndryshimi i ligjit aktual.

Andaj, në vazhdim do të paraqesim problemet dhe mangësitë të cilat synojmë që me plotësim-ndryshim të ligji t'i përmirësojmë.

Materiali arkivor të Fondkrijuesit, i cili i përmbush afatet ligjore për tu dorëzuar në Agjenci, nuk dorëzohet sipas metodologjisë profesionale të menaxhimit zyrtar në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare, por vjen i pa sistemuar, i pa evidentuar, i pa rregulluar dhe i dëmtuar (në kontejnerë, thasë të mbeturinave etj.).

Po ashtu, mos përgjegjshmëria e institucioneve fondkrijuese dhe fond-poseduese për mirëmbajtjen, ruajtjen dhe sistemimin e dokumenteve arkivore edhe pas inspektimit dhe këshillimit nga ana e Agjencisë përmes inspektorëve mbetet vetëm tentativë, dhe kjo vjen si pasojë pasi që *ligjit i mungon norma sanksionuese për Fondkrijuesit* që të zbatohet ky obligim.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës përballlet me vështirësi në aspektin infrastrukturor si në qendër, po ashtu edhe në arkivat ndërkomunale, *të cilat mjete në investime kapitale janë planifikuar me buxhetin e viteve 2019-2021.*

Me qëllim të ekspozimit ose promovimit të dokumenteve arkivore jashtë vendit, është e nevojshme që me ligj të garantohet **eksport-importi i dokumenteve** jashtë vendit e deri të kthimi në vendin e origjinës, mirëpo kjo dispozitë mungon në ligjin aktual.

Për pasurimin e fondeve dhe koleksioneve me dokumente të rëndësishme që kanë të bëjnë me vendin tonë dhe që i ofrohen Agjencisë, në *mungesë të dispozitës ligjore për blerjen e dokumenteve të rëndësishme arkivore* është e pamundur një gjë e tillë. Kemi rastin e ofrimit të materialeve të rëndësishme nga periudha e viteve të 90-ta, që i janë ofruar ASHAK-së për blerje nga Qendra Informative e Kosovës, dhe nuk ishte e mundur të bëhet në mungesë të kësaj të drejte.

Ruajtja dhe mbrojtja e dokumentacionit në kohë dhe rrethana të veçanta dhe të jashtëzakonshme qofshin ato fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara, sipas praktikave të vendeve të tjera duhet të jetë e paraparë dhe e rregulluar me ligj.

Mungesa e Organit (kolektiv) rekomandues/këshillëdhënës për arkiva, i cili do të jep këshilla për punët profesionale të veprimtarisë arkivore; analizon çështje të përgjithshme nga fusha e veprimtarisë arkivore; jep rekomandime dhe opinione mbi përparimin e veprimtarisë arkivore në Republikën e Kosovës, jep opinion mbi ushtrimin e funksioneve shkencore dhe kulturore të arkivave; jep rekomandime mbi shfrytëzimin e lëndës arkivore në arkiva para skadimit të afatit, si dhe rekomandon formimin e komisioneve të ndryshme në funksion të veprimtarisë arkivore.

Për të arritur nivelin e duhur të ngritjes profesionale të punonjësve arkivor është e nevojshme që këta punonjës të Licencohen në profesionin e arkivistit. Ky kualifikim mund të arrihet përmes provimit profesional për shërbimin arkivor që do të realizohet nga ASHAK, mirëpo edhe kjo duhet të rregullohet me dispozita ligjore.

Ndërrimi i emrit të Agjencisë, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në Agjencia Arkivore Shtetërore e Kosovës (AASHK), propozojmë të bëhet për qëllim të mos dublikimit të shkurtesave me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK).

Në ligjin aktual, Neni 9 paragrafi 2, në Institucionet që mund të ushtrojnë arkiv vetanak të hyj edhe:

- Ministria e Punëve të Jashtme, për shkak të natyrës së punës ku materiali arkivor është i shpërndarë nëpër ambasada në shtete të ndryshme;
- Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK): për shkaqe të historikut të pacientëve, ky fondkrijues e ka të domosdoshme mbajtjen e materialit arkivor edhe pas skadimit të afatit prej më shumë se 30 viteve.

Po ashtu, me plotësim-ndryshimin e ligjit synojmë të definojmë se kush e përbën rrjetin arkivor të Republikës së Kosovës. Pra, rrjeti arkivor përbëhet nga:

- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK), në kuadër të së cilës janë edhe Arkivat Ndërkomunale;

- Arkivat e Institucioneve publike e private – Fondkrijuesit;
- Arkivat Speciale;
- Arkivat private; dhe
- Institucionet e caktuara me Nenin 9, Paragrafi 2 i Ligjit 04/L-088, për Arkivat Shtetërore.

Me ligjin aktual mungon ndarja e kompetencave në mes të arkivave qendrore dhe lokale.

Në bazë të përvojës tonë, e veçanërisht pas hyrjes në fuqi të ligjit aktual kemi vërejtur se ka një paralelizëm në kompetencat e ASHAK-së (me arkivat ndërkomunale) dhe arkivave të komunave, ku ne e shohim si zgjidhje të domosdoshme definimin e saktë të kompetencave. Propozimi ynë është që arkivat e komunave të jenë arkiva të komunave si fondkrijuese, që nënkupton se Arkivat e Komunave të merren me dokumentacionin që e krijon Asambleja Komunale, Kryetari i Komunës, Bordi i Drejtorëve dhe organet varëse përbrenda Komunës. Ndërsa, Arkivat Ndërkomunale që janë pjesë e zgjatur e ASHAK-së kanë kompetencë që të merren me gjithë lëndën arkivore të të gjitha institucioneve në gjithë territorin që e mbulojnë. Pra, duhet të bëhet ndarje e qartë e kompetencave në mes të Arkivave Ndërkomunale (që janë pjesë e zgjatur e ASHAK-së) në njërën anë dhe Arkivave të Komunave, të cilat në praktikën e deritashme kanë synuar të mbulojnë Fondkrijuesit e gjithë komunës, ndryshe do të ishin organe paralele.

Duke i marrë parasysh çështjet e lartpërmendura është vlerësuar si nevojë e domosdoshme plotësim-ndryshimi i ligjit ekzistues, me qëllim të përmirësimit të shërbimit arkivor në vendin tonë.

Informata

Agjencia Shtetëror e Arkivave të Kosovës me vendim të Qeverisë Nr. 05/119 dt. 23.11.2016 nga 01.01.2017 bartet nga Zyra e Kryeministrit në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. ASHAK posedon 7938.78 metra gjatësi lëndë arkivore në letër të formateve të ndryshme (1310 fonde dhe koleksione arkivore); 25 km gjatësi lineare mikrofilma me 800,000 dokumente; 202 tituj të filmave dokumentar dhe artistik me 1000 rollne; menaxhon me mbi 260,000 dokumente digjitale të sjella nga hulumtimet prej arkivave simotra të vendeve të ndryshme, si dhe me 185,000 dokumente të skanuara nga fondi i mikrofilmave dhe fondeve që posedon ASHAK. Ky numër i dokumenteve digjitale rritet për çdo muaj me 3000 dokumente digjitale sipas planit të punës me resurset aktuale.

Mirëpo, 48 % e lëndës arkivore të lartpërmendur është e pa përpunuar, e pa rregulluar dhe e pa sistematizuar në aspektin profesional, si pasojë e mungesës së resurseve njerëzore.

Si pasojë e sasisë të lëndës së pa rregulluar, dhënia në shfrytëzim për hulumtime shkencore dhe profesionale, si dhe për nevoja tjera që janë me interes për institucionet, organizatat, personat fizik dhe ata juridik është një sfidë në vete me të cilën përballen çdo ditë arkivistët e ASHAK-së, e posaçërisht komuniteti që ka nevojë për shfrytëzimin e kësaj lënde arkivore.

Numri i fondkrijuesve të regjistruar në ASHAK është 1310 dhe trendi është në rritje. Gjatë një viti kryhen rreth 500 inspektime tek fondkrijuesit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Rreth 80% të fondkrijuesve nuk e kanë dokumentacionin e rregulluar sipas standardeve, nuk i kanë të hartuara listat me afate të ruajtjes, nuk i kanë krijuar kushtet për ruajtje, që ne mendojmë se kjo është si pasojë e mungesës së masave ndëshkimore në Ligjin aktual, masa të cilat në vendet tjera janë paraparë dhe zbatohen me legjislacionin e tyre, madje edhe ligjet e mëparshme e kishin kapitullin e dispozitave ndëshkimore, (Ligji Nr. 2003/7, për Lëndën Arkivore dhe Arkivat – Neni 46).

Politika aktuale

Aktualisht është në fuqi Ligji 04/L -088 për Arkivat Shtetërore, përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji është Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, mekanizmat vartës të saj, si dhe institucionet tjera fondkrijuese (institucionet publike dhe private).

Agjencia është institucion i cili pranon, evidenton, ruan dhe publikon lëndën arkivore dhe mundëson shfrytëzimin e saj për hulumtime shkencore dhe punë profesionale, si dhe për nevoja tjera të cilat janë në interes për institucionet, organizatat, personat fizik dhe juridik. Agjencia këshillon dhe udhëzon sipas nevojës institucionet të cilat hyjnë në fushëveprim të këtij Ligji lidhur me administrimin e lëndëve arkivore, ruajtjen dhe mbrojtjen e saj. Organizon trajnime, kurse, ligjërata për aftësimin profesional të kuadrit arkivor në Kosovë, si dhe kryen punë dhe aktivitete tjera të përcaktuara me Ligj dhe sipas standardeve arkivore ndërkombëtare.

Rrjeti arkivor ka për qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e përshtatshëm të lëndës arkivore dhe zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë arkivore. Ky rrjet funksionon nëpërmjet ndërlidhjes të të gjitha institucioneve arkivore në Kosovë.

Të gjitha institucionet publike, private, personat fizik dhe juridik (fondkrijuesit), që posedojnë lëndë arkivore të krijuar gjatë veprimtarisë së tyre, janë të obliguar që pas përmbushjes së afatit të përcaktuar me këtë Ligj t'i dorëzojnë lëndët me vlerë të përhershme për ruajtje në Agjenci.

Mënyra e dorëzimit të lëndëve arkivore në Agjenci duhet të bëhet sipas metodologjisë profesionale shkencore, me ç'rast ky material duhet të jetë i sistemuar dhe i evidentuar sipas sistemit të menaxhimit zyrtar në Kosovë dhe standardeve ndërkombëtare.

Agjencia në kuadër të mandatit të vet inspekton në mënyrë të rregullt fondkrijuesit për mënyrën e mirëmbajtjes, ruajtjes, evidentimit, krijimit të kushteve për ruajtje të lëndës arkivore e deri te procedura e dorëzimit - pranimit të materialeve arkivore në Agjenci.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës vazhdimisht bën përpjekje permanente që të jetë sa më afër fondkrijuesve nëpërmjet inspektimeve të rregullta, këshillave profesionale, mbajtjes vjetore të trajnimeve, kurseve, ligjëratave. Gjendja aktuale e dokumenteve që i posedojnë nuk është e mirë, si pasojë e mos ekzistimit të masave ndëshkimore.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Për rregullimin e fushës arkivore, përveç Ligjit për Arkiva këtë fushë e prekin edhe Ligjet e tjera, në mënyrë të tërthortë në raport me këtë çështje, si:

Ligji Nr. 04/L-088, për Arkivat Shtetërore - ky Ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e fushës arkivore në Institucionet e Republikës së Kosovës, që nga krijimi, ruajtja, mbrojtja menaxhimi e deri te dhënia në shfrytëzim e materialit dokumentar e arkivor.

Mirëpo, mungojnë disa dispozita, e po ashtu edhe disa dispozita kanë nevojë për riformulim apo plotësim ndryshim të cilat po e vështirësojnë zhvillimin e veprimtarisë arkivore në Kosovë, si : mungesa e Organit rekomandues/këshillëdhënës për arkiva; mungesa e dispozitave ndëshkimore; mungesa e dispozitave që e rregullojnë çështjen e eksport- importit të dokumenteve arkivore; mungesa e dispozitave mbi blerjen e lëndës arkivore; ruajtja e dokumentacionit në kohë dhe rrethana të veçanta dhe të jashtëzakonshme; licencimi i profesionit të arkivistit; ndarja e fondkrijuesve lokal dhe qendror dhe kompetencat e ASHAK-së dhe arkivave komunale; definimi me ligj i rrjetit arkivor. Këto mangësi në ligjin aktual po shkaktajnë probleme si dhe mosfunksionim të mirëfilltë siç kërkohet me standarde ndërkombëtare të veprimtarisë arkivore;

Ligji Nr. 04/L-184, për Administrimin e Punës në Zyrë - ky Ligj ka për qëllim administrimin e punës në zyre dhe dokumenteve zyrtare, që nga evidentimi fillestar deri në procedimin përfundimtar të tyre, në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe ndërmarrjet publike;

Ligji Nr. 03/L-172, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - Ky Ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale;

Ligji Nr. 03/L-178, për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë - Qëllimi i këtij ligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacioneve që kanë të bëjnë me interesat e sigurisë së Kosovës, si dhe për verifikimin e sigurisë të personave që kanë qasje në këto informacione;

Ligji Nr. 02/L-88, për Trashëgiminë Kulturore - Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë fushën e trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme, me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.

Përveç Legjislacionit primar të lartcekur këtë fushë e rregullojnë edhe Akte nën ligjore si në vijim:

Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2007, për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Asgjësimin e Materialit të Pavlefshëm Regjistraturik- Me këtë udhëzim rregullohet procedura e përzgjedhjes së lëndës arkivore dhe asgjësimit të materialit të pavlefshëm regjistraturik;

Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2007, për Dorëzim-Pranimin e Lëndës Arkivore- Më këtë udhëzim përcaktohet mënyra dhe procedura e dorëzim-pranimit të Lëndës arkivore publike dhe private në Arkivat e Kosovës;

Rregullorja Nr. 01/87/17, për Shfrytëzimin e Lëndës Arkivorë pranë ASHAK-ës. Më këtë rregullohen kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të materialit arkivor pranë ASHAK-ës, në këto fusha: procedurat dhe shfrytëzimi i materialit arkivor, kriteret dhe standardet për ruajtjen e materialit arkivor, krijimi i kopjeve dhe reproduktiveve, përgjegjësia e shfrytëzuesve të materialeve arkivore në rast të dëmtimit të së mirës arkivore, tarifatat dhe taksat për përdorimin e materialit arkivor dhe kompensimin për shpenzimet e krijuara me rastin e krijimit të kopjeve dhe reproduktiveve;

Rregullorja Nr. 01/2015, për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe Afatet e Ruajtjes së tyre - Me këtë Rregullore rregullohen shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve, përmbajtja e grupeve kryesore, si dhe afati i ruajtjes së dokumenteve.

Shpenzimet aktuale

12500 Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	Shpenzimi i vitit 2017	Buxheti 2018	Projeksionet 2019	Projeksionet 2020	Projeksionet 2021
Kategoritë e shpenzimeve	723,662	778,662	1,299,639	1,237,752	1,135,414
11 Paga dhe Mëditje	575,558	575,558	651,535	654,792	658,066
13 Mallra dhe Shërbime	120,519	120,519	120,519	166,263	249,763
14 Shpenzime Komunale	27,585	27,585	27,585	27,585	27,585
30 Shpenzime Kapitale		55,000	500,000	389,112	200,000

Në tabelën e sipërme është paraqitur buxheti i shpenzuar i vitit 2017, buxheti i aprovuar për vitin 2018 dhe projeksionet buxhetore 2019-2021 për ASHAK-së nëpër kategori të shpenzimeve.

Theks i veçantë duhet ti kushtohet: blerjes së kutive arkivore; mirëmbajtja e Arkivave Ndërkomunale, pasi që në disa Arkiva zyrtarët vetë pastrojnë zyrat; sigurimin fizik të objekteve të Arkivave Ndërkomunale, ku asnjë Arkiv Ndërkomunal nuk ka sigurim fizik; po ashtu blerja e inventarit për Arkivin Ndërkomunal Ferizaj, pajisje të teknologjisë, trajnimet e stafit si dhe vizitat mjekësore të zyrtarëve, pasi që për këtë na obligon Ligji Nr. 04/l-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, neni 17 pika 5.

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës ka një fond buxhetor të limituar, për tri (3). vite me radhë për shpenzimet operative, ndërsa për investime kapitale janë paraparë 1,144,112 euro për ndërtimin e depoz, digjitalizim të materialit arkivor dhe renovim të objektit ekzistues.

Mjetet financiare janë menaxhuar nga ASHAK si nën program buxhetor 12500 në kuadër të MRKS me kod organizativ 207, duke raportuar në MRKS për shpenzimet, të hyrat, pasuritë kapitale, jo kapitale dhe obligimet.

Agjencia ka vështirësi në aspektin infrastrukturor, ku posedon objektin (në Prishtinë), i cili është i ndërtuar për Arkivin e Kosovës nga viti 1977, mirëpo deri më tani nuk ka pasur asnjë investim në këtë objekt. Depot ku ruhen lëndët arkivore nuk janë të pajisura me sistem të aklimatizimit, ku temperaturat duhet të jenë konstante për ruajtjen e dokumenteve 18-22 gradë celsius, mungon aparatura për mbrojtjen kundër zjarrit, objekti posedon sistemin e vjetër elektrik të viteve 70-ta, dyshemeja dhe tavanet e dëmtuara, nyjat sanitare dhe dritaret e stërvjetruara, etj. Problem në vete mbetet hapësira e kufizuar, pasi që në ndërtesën e Agjencisë

janë të vendosura edhe institucione tjera siç janë: Agjencia Kadastrale e Kosovës, e cila e posedon tërë katin e dytë (II), Instituti i Historisë një pjesë të katit të parë (I) dhe përdhësës (12 zyre dhe dy salla).

Arkivat Ndërkomunale funksionojnë kryesisht në ambiente të përbashkëta me Institucionet tjera.

Sot, në kohën bashkëkohore nuk mund të mendojmë arkiva pa digjitalizim të dokumenteve arkivore, jo vetëm që është imperativ i kohës, por edhe domosdoshmëri e zbatimit të standardeve ndërkombëtare.

Agjencia ka arritur rezultate të kënaqshme dy vitet e fundit sa i përket digjitalizimit të lëndës arkivore edhe pse këto janë arritur me forca vetanake. Sot Agjencia punon me pajisje teknologjike të vjetruara për digjitalizim të dokumenteve arkivore.

Me të njëjtën sfidë apo edhe më të rëndë përballen edhe Arkivat Ndërkomunale nga aspekti infrastrukturor, përveç Arkivit Ndërkomunal të Pejës, që posedon objekt të vetin, të gjitha Arkivat tjera Ndërkomunale kanë në shfrytëzim të përkohshëm objekte të institucioneve tjera për të zhvilluar veprimtarinë arkivore, të cilat nuk i plotësojnë as kriteret elementare për zhvillimin e kësaj veprimtarie. Më e keqja është se materialet arkivore po dëmtohen edhe më shumë gjatë bartjes nga një objekt në tjetrin.

Përvoja në shtetet tjera

Agjencia në kuadër të bashkëpunimit të saj ka vizituar dhe ka marr praktikat më të mira të këtyre Shteteve: Kroacisë, Shqipërisë dhe Turqisë, ku edhe këto shtete në fushën e arkivave kanë tejkaluar sfidat të cilat janë të përafërta me problemet e shërbimit arkivor tek ne.

Provoja e këtyre shteteve është si në vijim:

Kroacia- Fushën e veprimtarisë arkivore e ka të rregulluar me Ligjin për lëndën arkivore dhe arkivat, aktet nënligjore, si dhe Statutin, me qëllim të përcaktimit të organizimit, funksionimit, kompetencat mbi fondkrijuesit, poseduesit e lëndëve arkivore dhe themelimin e mekanizmave të tjerë për mbrojtje të lëndëve arkivore me vlerë historike, shkencore e kombëtare. Shteti Kroat procesin e digjitalizimit të lëndës arkivore e ka një ndër më të profesionalizuarat në Evropë.

Gjithashtu, shteti Kroat me Ligjin e lartë cekur parasheh Këshillin, i cili ka mandat këshillëdhënës dhe ka treguar sukses në zbatimin e politikave në fushën e veprimtarisë arkivore. Arkivi Shtetëror Kroat, e ka kapitullin e sanksioneve në raste të shkeljes së dispozitave ligjore me penalizim në të holla për krijuesit dhe poseduesit e lëndës arkivore, të cilët nuk i përmbushin kriteret mbi evidentimin, rregullimin, përpunimin, përpilimin e listave me afate të ruajtjes, mbrojtjen, krijimin e kushteve të ruajtjes, dorëzimin në arkivin kompetent, dhënien në shfrytëzim të lëndës arkivore para skadimit të afateve të përcaktuara me ligj, etj., që ka mundësuar zbatim dhe monitorim më të mirë të politikave në fushën e veprimtarisë arkivore.

Shqipëria: Fushën e veprimtarisë arkivore shteti i Shqipërisë e ka të rregulluar me Ligjin për arkivat dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave me Ligjin e lartë cekur parasheh Këshillin, i cili ka mandat vendimmarrës dhe ka rezultuar me sukses në zbatimin e politikave në fushën e veprimtarisë arkivore.

Këshilli përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e zgjedhur nga radhët e specialistëve dhe të punonjësve të rrjetit arkivor shtetëror që administrohet nga vetë Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Anëtarët e jashtëm të Këshillit caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si: Tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave ose të institucioneve në varësi të saj; Dy përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe/ose të institucioneve në vartësi të saj; Dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës; Dy përfaqësues të arkivave të sistemit.

Turqia: Fushën e veprimtarisë arkivore shteti i Turqisë e ka të rregulluar me Ligj të veçantë, ku mbulon fushë veprimtarinë e Rrjetit arkivor. Arkivat e Turqisë si praktikë më të suksesshme e kanë digjitalizimin e dokumenteve arkivore, të realizuar përmes një kompanie private të kontraktuar.

Si praktikë më e dëshmuar për funksionim sa më të suksesshëm të fushës së veprimtarisë arkivore konsiderojmë praktikën (mixe) mes Shqipërisë dhe Kroacisë për funksionim në vendin tonë.

Për të mos krijuar kosto shtesë ne synojmë që me plotësim-ndryshim të ligjit të krijojmë organin e brendshëm rekomandues-këshillëdhënës sipas modelit Kroat.

Organi do të përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë duke përfshirë Drejtorët e Departamenteve, si dhe Drejtorët e Drejtorateve të Arkivave Ndërkomunale. Për punët dhe detyrat e organit do të nxirret një akt nënligjor.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Agjencia ka për qëllim apo synim zhvillimin e politikës në lidhje me përmirësimin e ngritjes dhe funksionalizimin e plotë të rrjetit arkivor, resurseve njerëzore, infrastrukturën fizike, grumbullimin e materialeve arkivore, që janë maturuar për tu dorëzuar në arkiv, digjitalizimin e dokumenteve etj.

Objektivat

Mungesa e kapaciteteve njerëzore ka bërë që ne 48% të lëndës arkivore ta kemi të pa rregulluar. Lënda e pa rregulluar rrezikon gjithmonë të dëmtohet. Edhe pse arkivistët e ASHAK-së punojnë me normën më të lartë në rajon, me stafin aktual nuk mund të kap hapin për përmirësim të gjendjes.

Andaj, objektivi për realizimin e misionit të arkivave është:

Menaxhimi dhe digjitalizimi i dokumenteve arkivore ku parashihet përcjellja dhe mbikëqyrja në regjistratura (te fondkrijuesit) dhe kompetenca për të dhënë vërejtje, propozime dhe rekomandime duke përfshirë shqiptimin e masave ndëshkimore për mosrealizimin e tyre. Ndërsa, digjitalizimi i dokumenteve arkivore është që të jemi sa më afër komunitetit dhe kërkesave gjithnjë në rritje të hulumtuesve shkencorë dhe atyre institucional ku është i nevojshëm edhe përdorimi i mjeteve moderne të teknologjisë informative që do të lehtësonte në masë të madhe shkëmbimin e dokumenteve me arkivat simotra ndërkombëtare, shfrytëzimin e informacioneve që ofrojnë dokumentet dhe do të ndikonte njëkohësisht edhe në ruajtjen fizike të tyre nga shkatërrimi i mundshëm fizik, e posaçërisht do ta ngriste efikasitetin për shfrytëzim të lëndës arkivore nga hulumtuesit.

Ngritja e stafit profesional - i cili do të evidentonte, rregullonte, sistemonte dhe përpunonte dokumentet e fondeve dhe koleksioneve arkivore me dinamikë adekuate.

Përmirësimi i infrastrukturës fizike - për të arritur standardet e ruajtjes së dokumenteve dhe për të plotësuar normat ndërkombëtare të ruajtjes fizike të dokumenteve është më se e nevojshme që të krijohen kushtet e infrastrukturës fizike për mbrojtjen dhe ruajtjen e lëndës arkivore (hapësirat e mjaftueshme, aklimatizimi, sistemi i mbrojtjes nga zjarri, raftet, etj.).

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Me vazhdimin e kësaj situate edhe më tej do thellohen problemet për menaxhimin dhe funksionalizmin më të mirë të veprimtarisë arkivore në Kosovë. Mungesa e Organit rekomandues/këshillëdhënës për arkiva; mungesa e dispozitave ndëshkimore; mungesa e dispozitave që e rregullojnë çështjen e eksport- importit të dokumenteve arkivore; mungesa e dispozitave mbi blerjen e lëndës arkivore; ruajtja e dokumentacionit në kohë dhe rrethana të veçanta dhe të jashtëzakonshme; licencimi i profesionit të arkivistit; kompetencat e arkivave lokale dhe qendrore; definimi me ligj i rrjetit arkivor; ndërrimi i emrit të Agjencisë, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në Agjencia Arkivore Shtetërore e Kosovës (AASHK), do të ndikojë në ngritjen e përqindjes së dokumenteve të pa përpunuara, dëmtim të mëtejshëm të tyre, pamundësinë e pranimit të dokumenteve që janë maturuar sipas ligjit, për shkak të mungesës së hapësirave dhe kapaciteteve njerëzore. Mos ndryshimi i Ligjit, do ta thellojë dhe përkeqësojë gjendjen aktuale të arkivave.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet me plotësim-ndryshimin e Ligjit aktual, duke përcaktuar dispozitat shtesë për rregullimin e fushës së veprimtarisë arkivore.

Plotësim ndryshim i Ligjit do të përmbajë këto dispozita:

-Rrjeti arkivor i Republikës së Kosovës do të përbëhet nga: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Arkivat Ndërkomunale, Arkivat e institucioneve publike e private, Arkivat Speciale, Arkivat Private dhe Institucionet e caktuara me Nenin 9, Paragrafi 2 i Ligjit 04/L-088, për Arkivat Shtetërore.

Agjencia është institucioni më i lartë i Rrjetit arkivor të Kosovës, institucion qendror arkivor që vepron si organ qeveritar, i cili organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë arkivore në gjithë rrjetin arkivor të vendit.

Agjencia ruan, mbron dhe administron lëndët arkivore të institucioneve, organeve dhe organizatave publike, të personave juridik e fizik, të familjeve dhe subjekteve tjera të dorëzuara në Agjenci.

Në përbërje dhe vartësi të drejtpërdrejtë administrative dhe profesionale të Agjencisë janë arkivat Ndërkomunale në: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjiilan, e po ashtu si nevojë imediate planifikojmë themelimin e Arkivit Ndërkomunal në Ferizaj (nëse krijohen mundësitë buxhetore). Arkivat speciale të institucioneve dhe ato private që bëjnë pjesë në rrjetin arkivor të vendit kanë bashkëpunim të vazhdueshëm profesional me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.

Arkivat Ndërkomunale:

Arkivat Ndërkomunale të Republikës së Kosovës:

- Arkivi Ndërkomunal i Prishtinës, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Prishtinë, Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë, Lypjan, Drenas dhe Graçanicë;
 - Arkivi Ndërkomunal i Mitrovicës, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zveqan, Leposaviq dhe Zubinpotok;
 - Arkivi Ndërkomunal i Pejës, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Pejë, Deçan, Junik, Istog dhe Klinë;
 - Arkivi Ndërkomunal i Gjakovës, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Gjakovë, Malishevë dhe Rahovec;
 - Arkivi Ndërkomunal i Prizrenit, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Prizren, Mamushë, Suharekë dhe Dragash;
 - Arkivi Ndërkomunal i Gjilanit, i cili mbulon fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore të këtyre komunave: Gjiilan, Ferizaj, Kaçanik, Han i Elezit, Shtërpçë, Shtime, Kamenicë, Artanë (Novobërdë), Viti, Ranilluk, Partesh dhe Klllokot.
- Për shkak të gjerësisë së madhe gjeografike dhe numrit të madh të fondkrijuesve që tani për tani mbulon Arkivi Ndërkomunal i Gjilanit ne e shohim si të domosdoshëm themelimin e Arkivit Ndërkomunal të Ferizajt (nëse krijohen mundësitë buxhetore).

Arkivat Ndërkomunale administrojnë, ruajnë, mbrojnë, klasifikojnë dhe kategorizojnë dokumentet e trashëguara, si dhe dokumentet e arkivave të institucioneve lokale që veprojnë brenda territorit përkatës që e mbulojnë.

Arkivat Ndërkomunale janë të detyruara të regjistrojnë çdo pasuri arkivore që ekziston në territorin që e mbulojnë.

- **Organi rekomandues / këshillëdhënës** - do të themelohet me plotësim-ndryshimin e Ligjit. Ky Organ do të jep këshilla për punët profesionale të veprimtarisë arkivore; analizon çështje të përgjithshme nga fusha e veprimtarisë arkivore; jep rekomandime dhe opinione mbi përparimin e veprimtarisë arkivore në Republikën e Kosovës; jep opinion mbi ushtrimin e funksioneve shkencore dhe kulturore të arkivave; jep rekomandime mbi shfrytëzimin e lëndës arkivore në arkiva para skadimit të afatit dhe rekomandon formimin e komisioneve të ndryshme në funksion të veprimtarisë arkivore. Organi do të përbëhet nga Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorët e Drejtorateve Arkivore Ndërkomunale, i kryesuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë. Për punët dhe detyrat e Organit do të nxirret një akt nën ligjor, i cili do të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë.

- **Ndërrimi i emrit të Agjencisë**, nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK) në Agjencia Arkivore Shtetërore e Kosovës (AASHK), do të bëhet për qëllim të mos dublikimit të shkurtesave me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK).

- **Mundësia e blerjes së dokumenteve me vlerë historike, kulturore, shkencore e kombëtare**- të parashihet me Ligj. Në mënyrë që Agjencia të ketë mundësi të pasurimit të fondeve dhe koleksioneve prej poseduesve të dokumenteve në fjalë brenda dhe jashtë vendit. Për përcaktimin e vlerës së dokumenteve formohet komision nga ekspertë të fushave.

- **Eksportimi- importimi i dokumenteve**: dokumentet, fondet dhe koleksionet arkivore që ruhen në Agjenci, në arkivat private dhe speciale, për tu paraqitur në mjediset ndërkombëtare për qëllime të ekspozimit ose promovimi kulturor, si dhe për qëllime historiko- shkencore, duhet tu garantohet lëvizja e dokumenteve deri te kthimi në vendin e origjinës.

Përgjegjës për zbatim të eksport/importit të dokumenteve dhe lëvizjes së tyre do të jetë Organi kompetent i ASHAK-së, i caktuar me ligj ose akt nënligjor. Dokumentet arkivore me vlerë të përhershme dhe të rëndësishme të veçantë historike-kulturore për popullin dhe shtetin e Kosovës mund të nxirren jashtë vendit vetëm me pëlqim të komisionit profesional ose të një organi të caktuar të Agjencisë.

- **Ruajtja e dokumenteve në rrethana të jashtëzakonshme**: rrethanat e krijuara nga pasojat e fatkeqësive elementare (zjarri, vërshimet, tërmeti) raste lufte etj.

- *Ligji duhet të përmbajë Dispozitat ndëshkuese* në rast të shkeljeve ligjore, në mënyrë që Fondkrijuesit të cilët nuk i përmbushin kriteret mbi evidentimin, rregullimin, përpunimin, përpilimin e listave me afate të ruajtjes, mbrojtjen, krijimin e kushteve të ruajtjes, dorëzimin në Agjenci sipas ligjit dhe standardeve ndërkombëtare.

Me plotësim-ndryshimin e ligjit për arkivat shtetërore presim që situata do të përmirësohet në menaxhimin dhe funksionimin më të mirë të veprimtarisë arkivore në Kosovë. Pra, do të kemi ngritje më të madhe të përqindjes së dokumenteve të përpunuara, mbrojtje të lëndës arkivore, mundësinë e pranimi të dokumenteve që janë maturuar sipas ligjit, pranimin e dokumenteve arkivore të rregulluara sipas standardeve që kërkohen. Përgjegjës për zbatimin e ligjit do të jetë Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Nëse politika ekzistuese nuk ndryshohet, por sigurohen mjete financiare shtesë për funksionimin e veprimtarisë arkivore përfshirë edhe digjitalizimin dhe resurset shtesë të nevojshme njerëzore dhe trajnime për ta, gjendja në Agjenci do të përmirësohej dukshëm.

Shtimi i numrit të punonjësve do të përmirësonte gjendjen në rregullimin, përpunimin e fondeve dhe koleksioneve arkivore. Digjitalizimi do të përmirësonte dukshëm shfrytëzimin dhe ruajtjen e lëndës arkivore.

Mirëpo, gjendja në regjistratura prej nga është edhe burimi kryesor i problemit nuk do të ndryshonte fare, për shkak të mungesës së dispozitave ndëshkuese ligjore.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos marrja e ndonjë veprimi për ndryshim të politikës dhe situatës aktuale.	Përmirësimi i situatës me ndryshim-plotësim të Ligjit në fuqi.	Përmirësimi i situatës përmes mjeteve financiare shtesë për funksionalizimin e veprimtarisë arkivore, përfshirë digjitalizimin dhe sigurimin shtesë të resurseve njerëzore, dhe rregullimi i disa mangësive me nxjerrjen e akteve nën ligjore.
Sektori	Agjencia dhe Rrjeti Arkivor	Agjencia dhe Rrjeti Arkivor.	Agjencia dhe Rrjeti Arkivor.
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës për zbatim.	Agjencia dhe Rrjeti Arkivor, fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore.	Qeveria e R. Kosovës, Agjencia dhe Rrjeti Arkivor, fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore.	Qeveria e R. Kosovës, Agjencia dhe Rrjeti Arkivor, fondkrijuesit dhe poseduesit e dokumenteve arkivore.
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit .	////	//////	//////
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve	Ligji nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore	Plotësim ndryshimi i Ligjit aktual.	Ligji aktual, si dhe nxjerrja e akteve nën ligjore: Rrjeti arkivor, afati i pranim-

ekzistuese, si dhe zbatimi dhe dënimet.	Aktet nën ligjore: Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2007 për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Asgjësimin e Materialit të Pavlefshëm Regjistraturik; Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2007 Për Dorëzim-Pranimin e Lëndës Arkivore; Rregullorja për shfrytëzimin e lëndës arkivore Nr.01/87/17 në ASHAK		dorëzimit të dokumenteve arkivore, tarifat.
Stimulimet ose mos- stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	//////	////////	////////
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	//////	////////	////////
Udhëzimet dhe kodet	//////	////////	//////
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni.	Ligji është në fuqi	2017/18	2018

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1 - Edhe përkundër mangësive që ka treguar zbatimi i këtij Ligji në praktikë, megjithatë ky Ligj e mbulon fushën e veprimtarisë arkivore në Kosovë.

Opsioni 2 - Përmes hartimit të plotësim-ndryshimit të Ligjit do të rregulloheshin këto çështje: do të kemi ngritje të përqindjes së dokumenteve të rregulluara, mbrojtjen më profesionale nga dëmtimi i mëtejshëm i dokumenteve, ngritjen e sasisë së pranimi të fondeve dhe koleksioneve arkivore që janë maturuar për tu arkivuar; mekanizmi këshillëdhënës / rekomandues për zhvillim të politikave programore të arkivave; si dhe sigurimi për zbatueshmërinë e plotë të Ligjit nëpërmes masave ndëshkimore.

Opsioni 3 - Nëse politika ekzistuese nuk ndryshohet, por sigurohen mjete financiare shtesë për funksionimin e veprimtarisë arkivore përfshirë edhe digjitalizimin dhe resurset shtesë të nevojshme njerëzore dhe trajnime për ta, gjendja në Agjenci do të përmirësohej dukshëm. Disa mangësi të ligjit aktual do të rregulloheshin me nxjerrjen e akteve nënligjore.

Pasojat negative

Opsioni 1 - Vazhdimi i politikës ekzistuese do të shkaktonte thellimin e problemeve aktuale. Si pasojë e mungesës së masave ndëshkimore vjen deri te moszbatimi i ligjit aktual.

Opsioni 2 - Me nxjerrjen e plotësim ndryshimit të ligjit aktual lind nevoja për kosto shtesë buxhetore.

Opsioni 3 - Me ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit gjendja në regjistratura prej nga është edhe burimi kryesor i problemit nuk do të ndryshonte fare, për shkak të mungesës së dispozitave ndëshkuese ligjore.

Kapitulli 7: Konsultimi

Në procesin e hartimit të këtij Draft Koncept Dokumenti janë konsultuar ekspert nga Departamentet e Brendshme të Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, Sekretariati Koordinues i Qeverisë dhe Zyra Ligjore e Kryeministrit, të cilët edhe morën pjesë në hartimin e këtij Draft Koncept Dokumenti.

Procesi i konsultimit do të bëhet në pajtim me rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë.

Kapitulli 8: Krahاسimi i opsioneve

Opsioni 1. - Status-quo-ja - me vazhdimin e kësaj situatë gjendja do mbetet e pa ndryshuar në funksionalizimin e kësaj fushe. Zhvillimi i veprimtarisë arkivore me Ligjin në fuqi mbetet i mangët dhe nuk premtan për zhvillim progresiv.

Opsioni 2. - **Me nxjerrjen e plotësim-ndryshimit të Ligjit**- situata e funksionalizimit të fushës arkivore premtan se në të ardhmen do të zgjidhen problemet esenciale, të cilat sot hasin në vështirësi të shumta siç janë: mungesa e qartësimi të Rrjetit arkivor dhe sqarimi i detyrave dhe kompetencave arkivore; Organi këshillëdhënës / rekomandues; dispozitat ndëshkuese, afati i pranim-dorëzimit, mundësia e blerjes së dokumenteve arkivore, eksport- importi i dokumenteve arkivore, etj.

Opsioni 3. - Me ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit, pra me sigurimin e mjeteve financiare shtesë për funksionimin e veprimtarisë arkivore përfshirë edhe digjitalizimin dhe resurset shtesë të nevojshme njerëzore dhe trajnime për ta, gjendja në Agjenci do të përmirësohej dukshëm. Mirëpo, gjendja në regjistratura prej nga është edhe burimi kryesor i problemit nuk do të ndryshonte fare, për shkak të mungesës së dispozitave ndëshkuese ligjore.

Opsioni i cili do të ketë mundësi më së shumti që të arrijë synimin dhe objektivat tona për zgjidhjen e kësaj fushe është plotësim-ndryshimi i Ligjit për Arkiva Opsioni 2.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, të miratojë Koncept Dokumentin me opsionin e dytë (2) të rekomanduar, nxjerrja e Projekt Ligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit

Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore, i cili do të rregullon funksionalizimin e Rrjetit arkivor; themelimin e Organit këshillëdhënës / rekomandues; blerjen e dokumenteve arkivore, eksportin-importin e materialeve arkivore dhe dispozitat ndëshkuese.

Ky opsion **nuk** do të ketë implikime të pakta buxhetore, implikime buxhetore do të ketë me themelimin e Arkivit Ndërkomunal të Ferizajt (varësisht nga mundësitë buxhetore), që janë të paraqitura në formularin e vlerësimit të ndikimit financiar (. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës në bashkëpunim me MKRS do të hartoj e dorëzoj për miratim në Qeveri Projekt Ligjin për plotësim-ndryshim. Ligji Nr. 04/L-088, për Arkivat Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Kapitulli 10: Komunikimi

Me miratimin e koncept dokumentit Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës sipas rregullave dhe procedurave do tu komunikoj palëve të interesit vendimin potencial të Qeverisë për ndryshimet që do të bëhen në fushën e arkivave. Mënyra e komunikimit do të jetë e hapur, konform rregullores së Punës së Qeverisë. Mesazhi kryesor do të jetë njoftimi për mundësitë e reja që do të sjellë ndryshimi i ligjit për Arkivat Shtetërore.

Ky Draft Koncept Dokument u është dërguar për konsultim paraprak sipas nenit 7 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë të gjithë akterëve relevant, në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara, ndërsa komente kemi marr vetëm nga SKQ. Të gjitha rekomandimet e marra nga SKQ-ja janë inkorporuar në këtë Draft Koncept Dokument.